

**ALBCONTROL SHA**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë “Air Communication” sh.p.k. dhe ENAV S.P.A, me NIPT L32409042E me adresë: Rr. Xhorxh Martini, Vila nr. 16, kati I, Farkë, Ap.2, Tiranë me përfaqësues ligjor znj. Valentina Taipi, Via Salaria, 716 - 00138 Rome NIPT 02152021008 Reg. Imp. Roma - REA 965162

Procedura e prokurimit: REF-85935-09-17-2018, me objekt: “Studim “Kukës obstacle survey”, me vlerë limit 40 000 000 (dyzetë milion) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë:6 (gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 16 Tetor 2018, ora 12:00.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nuk ka.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Ofertuesi i parë: Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë “Air Communication” sh.p.k. me NIPT L32409042E dhe ENAV S.P.A me NIPT 02152021008
  - Çmimi i ofertës: 23 180 500 (njëzet e tre milion e njëqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh
  
2. Ofertuesi i dytë: Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë “B-VAAL Engineering” sh.p.k me NIPT L72023002P & “AIRIA Inginieria Y Servicios SA me NIPT A-84842097
  - Çmimi i ofertës: 19 800 000 (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind mijë lekë) lekë pa tvsh

3. Ofertuesi i tretë: Operatori Ekonomik “Consulting & Management Albania” sh.p.k. me NIPT K82206013U
  - Çmimi i ofertës: 36 800 000 (tridhjetë e gjashtë milion e tetëqind mijë) lekë pa tvsh
4. Ofertuesi i katërt: Operatori Ekonomik “Land & CO” sh.p.k. me NIPT J87730202A
  - Çmimi i ofertës: 39 000 000 (tridhjetë e nëntë milion) lekë pa tvsh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm :

- Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë “B-VAAL Engineering” sh.p.k. & “AIRIA Inginieria Y Servicios” SA nuk plotësonte:

Tek Kriteret e Përgjithshme për Pranim pikën a, ku thuhet shprehimisht:

*“Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim Operatorësh ekonomikë duhet të dorëzohen: Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht”*

Kontrata e bashkëpunimit midis Operatorëve Ekonomikë “B-VAAL Engineering” sh.p.k. dhe “Airia Inginieria Y Servicios SA”, nuk është sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 74 pika 2 “LPP” citojme *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, **përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit** dhe elementët konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi....”*.

Për sa më sipër kontrata e lidhur midis këtyre dy operatorëve ekonomikë nuk ka në asnjë pjesë të saj të përcaktuar përqindjen e secilit operator në këtë bashkëpunim. Për rrjedhojë kjo kontratë nuk është sipas kërkesave ligjore dhe si e tillë konsiderohet e pa vlefshme.

Nga vleresimi i dokumentacionit të paraqitur KVO konstatoi se ky operator ekonomik nuk plotësonte Kriteret për Kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 1. Kontratat e ngjashme të dorëzuara nuk plotesojne vlerën e kerkuar në këtë kriter ku duhet që operatori ekonomik të ketë kryer shërbime të ngjashme në vlerë sa 40% e fondit limit, ndërkohë që kontratat e paraqitura janë në vlerë më të vogël. Kontratat e paraqitura janë në vlerën 5 120 639 lekë pa tvsh.

Gjithashtu asnjëra nga ato nuk konsiderohet e ngjashme ndërkohë që kemi të bëjmë me harta aeronautike që janë specifike dhe duhet të plotësonin kriteret dhe detyrimet e përcaktuara nga organizatat ndërkombëtare në fushën e Aviacionit Civil.

Kontratat e paraqitura nga Operatori tjetër ekonomik AIRIA Inginieria Y Servicios SA nuk mund të merren në konsideratë kjo për faktin se Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë “B-VAAL Engineering” sh.p.k. & “AIRIA Inginieria Y Servicios” SA është i pavlefshëm, siç u shpjegua në pikën e mësipërme. Sa më sipër ky kriter nuk plotësohet.

Nga vleresimi i dokumentacionit të paraqitur KVO konstatoi se nuk plotësohet, Kriteret për Kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 8, citojmë:

*“OE, duhet të dorezojë skedulën me afatin kohor të të gjithë projektit, etapat e rëndësishme të punës dhe datat e proceseve të miratimit të përcaktuara në specifikime teknike dhe vendimeve thelbësore për t’u marrë nga ALBCONTROL SHA”.*

Rezulton se ky operator nuk e plotëson këtë pikë duhet të dorezonte një projekt teknik ku të përmbushte të gjitha kërkesat e përcaktuara në specifikime teknike, duhet të tregonte metodologjinë sesi do të realizonte projektin, proceset e miratimit, etj. Sa më sipër kjo pikë nuk plotësohet.

- Operatori Ekonomik “Land & CO” sh.p.k. kishte këto mangësi:

Nga vleresimi i dokumentacionit të paraqitur KVO konstatoi se ky operator ekonomik nuk plotëson Kriteret për Kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 1. Kontratat e ngjashme të dorëzuara nuk plotësojnë vlerën e kërkuar në këtë kriter ku duhet që operatori ekonomik të ketë kryer shërbime të ngjashme në vlerë sa 40% e fondit limit.

Në kontratën e paraqitur, Operatori Ekonomik “Land & Co” është pjesë e Bashkimit të përkohshëm të Operatorëve Ekonomikë “Land & Co” dhe “Universiteti Arsitotel i Selanikut” dhe “Sinder” sh.p.k.

Nuk kemi asnjë informacion ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, **përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementët konkrete, që ka kryer ose do kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi....**”. Shprehemi do kryejë sepse na ishte paraqitur vetëm një vërtetim realizimi për 65% punimeve të parashikuara në kontratë. Për sa më sipër kontrata e paraqitur nuk mund të merret në konsideratë dhe kjo pikë plotësohet.

Nga vleresimi i dokumentacionit të paraqitur KVO konstatoi se ky operator ekonomik nuk plotëson Kriteret për Kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 5, citojmë:

*“OE, duhet të jetë në zotërim të certifikatës PAS 99:2012 për Sistemin e Integruar të Menaxhimit. Ose ekuivalente me to. Certifikatat ISO duhet të jenë të lëshuara nga institucione zyrtare të akredituara për këtë qëllim dhe të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit”*

Çertifikata PAS 99:2012 nuk ishte paraqitur nga Operatori Ekonomik “Land & CO” sh.p.k. Pra kjo pikë nuk plotësohet.

Nga vleresimi i dokumentacionit të paraqitur KVO konstatoi se nuk plotësohet, Kriteret për Kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 8, citojmë:

*“OE, duhet të dorezojë skedulën me afatin kohor të të gjithë projektit, etapat e rëndësishme të punës dhe datat e proceseve të miratimit të përcaktuara në specifikime teknike dhe vendimeve thelbësore për t’u marrë nga ALBCONTROL SHA”.*

Rezulton se ky operator nuk plotëson këtë pikë, pasi duhet të dorezonte një projekt teknik ku të përmbushte të gjitha kërkesat e përcaktuara në specifikime teknike, duhet të tregonte metodologjinë sesi do të realizonte projektin, proceset e miratimit, etj. Sa më sipër kjo pike nuk plotësohet

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë “Air Communication” sh.p.k. dhe ENAV S.P.A, me NIPT L32409042E me adresë: Rr. Xhorxh Martini, Vila nr. 16, kati I, Farkë, Ap.2, Tiranë me përfaqësues ligjor znj. Valentina Taipi, Via Salaria, 716 - 00138 Rome NIPT 02152021008 Reg. Imp. Roma - REA 965162, ka paraqitur ofertën me vlerë: 23 180 500 (njëzet e tre milion e njëqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh, e cila është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë ALBCONTROL SHA, me adresë në Aeroportin Nënë Tereza Rinas, pranë Zyrës së Prokurimeve, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej / 36 800 000 (tridhjetë e gjashtë milion e tetëqind mijë)], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18.10.2018

□